

UDHËZUES MBI MBROJTJEN E PJESËTARËVE TË PUBLIKUT

Ky Udhëzues u drejtohet punëdhënësve, menaxherëve dhe personave të tjerë brenda vendit të punës që kanë një përgjegjësi për shëndetin dhe sigurinë.

Ky Udhëzues duhet të përdoret si një ndihmë për zhvillimin e sistemeve të sigurta të punës, kurdo që kryhen aktivitete në hapësirat publike.



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija,

Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers

Inspektorati i Punës/ Inspektorata Rada/ Labour Inspectorate

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	1
PUNA QË PREK PUBLIKUN	2
GRUPET DHE MJDISET E NDJESHME TË CILAT KËRKOJNË VËMENDJE TË VEÇANTË	3
PLANIFIKIMI, SIGURIMI DHE MIRËMBAJTJA E PERIMETRAVE	4
SIGURIA PUBLIKE - FUSHAT KRYESORE TË SHQETËSIMIT	6
ZHVILLIMI I PROCEDURAVE TË AUTORIZIMIT	8
AUDITIMET	9
VËREJTJET PËRFUNDIMTARE.....	9
SHTOJCA	10



HYRJE

Çdo vit si rezultat i punës së tyre në ndërtimtari vriten ose lëndohen shumë punëtorë , ndërsa të tjerët vuajnë nga shëndeti i keq, siç janë çrregullimet muskulo-skeletore, dermatiti ose asbestoza. Megjithatë, rreziqet nuk janë të kufizuara vetëm për ata që punojnë në vendndërtime. Fëmijët dhe pjesëtarët e tjerë të publikut gjithashtu vriten ose lëndohen sepse aktivitetet ndërtimore nuk kontrollohen në mënyrë adekuate.

Menaxhimi i sigurisë në një kantier ndërtimi dhe respektimi i ligjeve dhe kërkesave të sigurisë mund të duket një detyrë e mundimshme, por gjithsesi duhet të merret seriozisht, veçanërisht nëse jeta e njeriut është në rrezik.

Një vend pune me aktivitete të shumta mund të ketë ekipe të shumta tregtarësh, lëvizje të vazhdueshme automjetesh, makineri dhe mjete potencialisht të rrezikshme. Të gjitha këto duhet të përfshihen në një vlerësim të rrezikut për të mbrojtur punëtorët tuaj dhe publikun e gjerë nga rreziku. Në këtë udhëzues, do të përshkruajmë disa nga rreziqet kryesore në një kantier ndërtimi, çfarë mund të bëhet për të menaxhuar me përgjegjësi ato rreziqe dhe për t'u siguruar që kantieret tuaja janë të sigurta dhe me rrezik minimal për publikun.

FUSHËVEPRIMI DHE QËLLIMI

Ky udhëzues u drejtohet të gjithë atyre që janë të përfshirë në procesin e ndërtimit. Ky udhëzues do t'ju ndihmojë të kuptoni se çfarë duhet të bëni për të respektuar Ligjin Nr. 04 /L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe Rregulloren e MPMS-së Nr. 06/2017 për kriteret minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendndërtimet të përkohshme apo mobile.

Udhëzuesi siguron këshilla praktike se si personat përgjegjës, të cilët projektojnë, planifikojnë, mirëmbajnë dhe kryejnë punë ndërtimore, mund të minimizojnë rreziqet për ata që nuk janë të përfshirë në procesin e ndërtimit, por që mund të preken nga ato rreziqe.

Udhëzuesi përfshinë mënyrën se si mund ta përcaktohet dhe mirëmbahet perimetri i kantierit dhe si të mbahet publikun larg nga punimet e ndërtimit. Udhëzuesi thekson rëndësinë e autorizimit të punëtorëve dhe vizitorëve që vijnë në kantierin tuaj, madje edhe për periudha të shkurtra. Ai gjithashtu shpërfaqë se ku ka më shumë të ngjarë të hasen probleme, duke sugjeruar mënyrat për t'i kontrolluar ato.

Është e pamundur të sigurohen detaje që mbulojnë të gjitha situatat ku aktivitetet e ndërtimit mund të ndikojnë në vendet publike. Parimet e dhëna këtu mund të përshtaten për t'u zbatuar në një sërë aktivitetsh në kantier.



PUNA QË PREK PUBLIKUN

Nuk janë vetëm punëtorët që janë në rrezik nga punimet ndërtimore. Pjesëtarët e publikut vriten dhe lëndohen rëndë çdo vit. Fatkeqësisht, edhe fëmijët shpesh përfshihen në mesin e të vdekurve dhe të lënduarve.

Shpesh ndodh që aksidentet të paraqiten kur njerëzit janë duke ecur pranë një ndërtese që është në ndërtim e sipër, duke u rinovuar ose shkatërruar, ose duke ecur pranë punimeve në rrugë p.sh. gërmimet në rrugë. Mos harroni, kur punoni në vende publike, puna duhet të planifikohet dhe ekzekutohet ashtu që të marren parasysh nevojat e fëmijëve, personave me karroca, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.

Mënyra më e mirë për të mbrojtur pjesëtarët e publikut është t'i mbash ata larg zonës ku kryhen punimet. Një gjë e tillë përgjithësisht arrihet duke ngritur një rrethojë të lartë rreth perimetrit të ndërtimit. Nëse duhen të bëhen ndryshime ose disa nga rrethojat duhet të hiqen përkohësisht, duhet të siguroheni që t'i vendosni ato përsëri para se të largoheni nga vendi i punës qoftë për pushim dreke ose në fund të orarit të punës.

Mbyllni portat e kantierit të ndërtimit dhe gjitha dyert dhe dritaret e tjera gjatë natës. Nëse puna bëhet në ambiente të banuara, përgjegjësitë për mirëmbajtjen e rrethojës dhe ruajtjen e publikut larg vend ndërtimeve duhet të bëhen në pajtim me banorët e ndërtesës. Nëse vendndërtimi ndodhet afër një shkolle, ose pranë shtëpive, mund të jetë e dobishme të kontaktoni drejtuesin e shkollës ose këshillin e banorëve, etj., për të kërkuar ndihmën e tyre me qëllim të mbajtjes së fëmijëve larg qasjes në atë vendndërtim.

Shumë fëmijë i shohin kantieret e ndërtimit si terrene aventureske. Edhe pse ata mund të hyjnë në kantier pa leje, prapë se prapë duhet të mbrohen nga rreziqet që mund të paraqiten në një vendndërtim.





GRUPET DHE MJEDISET E NDJESHME TË CILAT KËRKOJNË VËMENDJE TË VEÇANTË

Grupet e ndjeshme, të tilla si të moshuarit, fëmijët dhe njerëzit me aftësi të kufizuara mund të kenë nevojë për vëmendje të veçantë. Puna në ambiente të caktuara siç janë shkollat dhe spitalet kërkon vëmendje dhe planifikim të kujdesshëm. Kjo pjesë ofron këshilla më të hollësishme për disa nga fushat që do të adresohen.

Disa nga sugjerimet mund të vlejné edhe për mjedise të tjera të punës.

Personat me aftësi të kufizuara



Personat me aftësi të kufizuara janë veçanërisht të rrezikuar kur punimet e ndërtimit ndikojnë në shtigjet e këmbësorëve p.sh. instalimi i kablllove të televizionit ose ngritja e skeleve në trotuare. Prandaj është e rëndësishme të identifikohet nëse puna juaj do të ndikojë në një rrugë që përdoret rregullisht nga njerëzit me aftësi të kufizuara ose jo.

A kalojnë shpesh personat me karroca nëpër atë rrugë? A mund të rrezikohen personat e verbër ose me shikim të kufizuar? Ekzistojnë disa masa të cilat duhet të merren parasysh, p.sh. ndriçimi i skelave dhe kontejnerëve të mbeturinave, rivendosja e shtigjeve të këmbësorëve, etj.

Fëmijët



Vdekja ose lëndimi i një fëmije është veçanërisht tragjike dhe duhet bërë shumë përpjekje për t'i mbajtur ata larg kantierëve të ndërtimit dhe larg rrezikut. Fëmijët nuk kanë aftësi të perceptojnë rrezikun në të njëjtën mënyrë si të rriturit.

Diskutoni për mënyrat se si fëmijët mund të vetëdijesohen për rreziqet dhe të mbahen jashtë kantierëve të ndërtimit, kërkon këshilla nga prindërit ose kujdestarët e tyre, mësuesit etj. Dërgimi i letrave rreth njoftimit për ndërtimet që do të zhvillohen, tek familjet që janë në afërsi mund të jetë një mënyrë e dobishme për të informuar banorët në lidhje me punimet. Biseda me fëmijët dhe shfaqja e filmave ose videove do të rrisë ndërgjegjësimin e tyre dhe mund të ndihmojë në uljen e aksidenteve, incidenteve, të cilat lidhen me hyrjen në ambiente të caktuara pa leje dhe vandalizimeve. Sidoqoftë, të gjitha këto mund të japin efekt të kundërt dhe në të vërtetë më tepër mund të inkurajojnë fëmijët të provojnë dhe hyjnë në kantiere ndërtimi dhe jo t'i pengojnë ata nga e kundërta. Përbajtja e tyre duhet të mendohet me shumë kujdes për të shmangur një gjë të tillë. Policia lokale mund të pranohet të marrë pjesë në aktivitete të ngjashme.

Menaxhimi i kantierit të ndërtimit duhet të bëjë që nën-kontraktorët, furnizuesit dhe vizitorët e tjerë të jenë të vetëdijshëm lidhur me të gjitha kufizimet sa i përket fëmijëve para se ata të arrijnë në kantier. Kjo është veçanërisht e rëndësishme gjatë pushimeve të shkollës kur fëmijët mund të kenë më shumë të ngjarë që p.sh. të shoqërojnë prindërit e tyre në kamionë. Duhet të ndërmerren hapa të përshtatshëm në lidhje me fëmijët për të siguruar që të gjithë respektojnë rregullat e kantierit.



Puna në ambientet e shkollës shpesh kërkon standardet më të larta të mbrojtjes publike: p.sh., mund të kenë nevojë të rregullohen panelet e drurit rreth bazës së skelave për të parandaluar fëmijët që të ngjiten në to. Tunelet dhe rrethojat mund të jenë të nevojshme të vendosen pranë këndeve të lojërave dhe hyrjeve për të parandaluar goditjen e nxënësve, stafit dhe prindërve nga objektet që kanë gjasë të bien.

Autoritetet lokale dhe organet drejtuese të shkollës zakonisht do të kenë procedura për kontrollimin e aktiviteteve të ndërtimit. Kontraktorët duhet të familjarizohen me këto dhe të zhvillojnë sisteme për të përmbushur kërkesat e tyre gjatë fazave më të hershme të planifikimit të projektit.

Kurdoherë që është e mundur, projektet ose aktivitetet që paraqesin rreziqe të mëdha për stafin dhe nxënësit duhet të kryhen gjatë pushimeve shkollore, gjatë fundjavave ose jashtë orarit të shkollës. Nëse kjo nuk është e mundur, puna duhet të programohet për të shmangur periudhat kohore kur mund të ketë turma të shtuara të nxënësve siç janë fillimi, mbarimi dhe pushimi në shkollë. Furnizimet e ndryshme në shkolla gjithashtu duhet të rregullohen për të shmangur këto periudha kohore.

PLANIFIKIMI, SIGURIMI DHE MIRËMBAJTJA E PERIMETRAVE

Për shumicën e kantierëve të ndërtimit, perimetri është një zonë gjeografike brenda së cilës do të kryhen punimet e ndërtimit. Përcaktimi i këtij perimetri është një aspekt i rëndësishëm i menaxhimit të rrezikut publik. Mund të ketë zona specifike të rrezikut brenda kantierit të ndërtimit, të tilla si rreth gërmimeve të thella. Ndonjëherë puna e ndërtimit mund të krijojë rreziqe jashtë perimetrit të kantierit (p.sh. shkarkimi i materialeve nga një kamion i dërgesës jashtë perimetrit).

Tre çështje që duhet të merren parasysh:

1. Planifikimi se çfarë forme do të marrë perimetri
2. Sigurimi i perimetrit
3. Mirëmbajtja e asaj që është siguruar.

Identifikimi i çështjeve në fazën para-tenderit lejon që të përfshihen në faturën e sasive artikuj të veçantë, të cilët mund të merren parasysh nga kontraktorët “kryesorë” të ardhshëm gjatë tenderimit. Një e gjë e tillë në fund të projektit do të ndihmojë në zvogëlimin e mundësisë së tejkalimit të shpenzimeve në këtë fushë.



Vlerësimi i riskut duhet të vendosë se si do të përcaktohen perimetrat, çfarë lloji do të nevojitet për të mbrojtur publikun dhe ku duhet të vendosen. Faktorët që do të merren parasysh do të përfshijnë:

- Natyrën dhe llojin e punës ndërtimore
- Sa e populluar është zona
- Kush do të duhet të vizitojë kantierin gjatë punës
- Nëse kantieri i ndërtimit mund të jetë tërheqës për fëmijët
- Karakteristikat e kantierit të ndërtimit.


Kur planifikoni rreth dërgesave të materialeve, ka shumë masa paraprake pozitive, të cilat mund të ndërmerren për të siguruar që njerëzit jashtë kantierit të ndërtimit të mbrohen, përfshirë:

- Eliminimin e ngasjes prapa në rrugë ose në kantier duke siguruar rrugë njëkahore dhe aty ku është e mundur të krijohet zona për kthim brenda kantierit,
- Sigurimi i zonave të veçanta për ngarkim për lëvizje më të sigurt të mallrave në kantier
- Planifikimi i dërgesave për t'u siguruar që ato nuk përkojnë me trafikun e madh të këmbësorëve, siç është koha kur fëmijët merren nga shkollë
- Planifikimin që dërgesat të bëhen në kohë jashtë lëvizjeve të mëdha të njerëzve siç janë orët e pikut ose vajtje-ardhjet nga dhe në shkollë.

Sidoqoftë, mund të jetë e nevojshme të zgjerohet përkohësisht perimetri ekzistues i kantierit të ndërtimit për aktivitete me rrezik më të lartë, të tilla si përdorimi i vinçave ose pirunjerëve për shkarkim. Mund të kërkohen rrugë alternative për këmbësorët dhe kjo shpesh do të ketë nevojë për leje nga autoritetet lokale.

Perimetri i kantierit

Në shumë kantierë ndërtimi, vendndodhja e perimetrit të tyre do të jetë e qartë. Shtrirja e kantierit dhe karakteristikat e tij do të ndikojnë në pozicionin e rrethojës së perimetrit, p.sh. mund të jetë e mundur të merret në konsideratë përdorimi i veçorive ekzistuese të përhershme, të tilla si muret, rrethojat ose strukturat e tjera me kusht që ato të jenë të pa dëmtuara.



Mund të ndodh gjithashtu që ndërtimi i strukturave të reja të bëhet në etapa të ndryshme ashtu që ato të formohen pengesa efektive në vazhdimësi të punës. Kur strukturat ekzistuese nuk mund të përdoren, ju duhet të vendosni se cilat materiale do t'i përdorni për të krijuar një pengesë të përshtatshme sipas nevojës.

Masat paraprake të ndërmarra për të siguruar perimetrin e vendit duhet të pasqyrojnë nivelin e rrezikut. Vendndodhja e zyrave të kantierit do të duhet të merret parasysh gjatë planifikimit të kantierit dhe ato preferohet të vendosen pranë hyrjes kryesore të kantierit. Kjo lejon mbikëqyrjen e atyre që vijnë, duke shmangur mundësinë që njerëzit të kalojnë nëpër kantier pa nevojë. Rrugët e hyrjes dhe hyrja në zyrën e kantierit duhet të jenë të shënuara qartë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur ka hyrje të shumta, ku kantieri është i



përbashkët, ose ku zyra është e vendosur jashtë rrethojës së perimetrit. Kufizimet në hapësirë do të ndikojnë në aktivitete të tilla si shpërndarja e mallit dhe shkarkimi në kantier dhe mund të ndikojë në llojet e impiantit dhe teknikat e ndërtimit që mund të përdoren.

Gjatë planifikimit të projektit duhet të identifikohen çështje të caktuara lokale siç janë shtigjet publike ose të drejtat e kalimit që mund të bien nëpër kantiere. Do të jetë e nevojshme të merret parasysh mbyllja ose devijimi i duhur i tyre, me pëlqimin e pronarit dhe autoriteteve përkatëse sa më shpejt të jetë e mundur.

SIGURIA PUBLIKE - FUSHAT KRYESORE TË SHQETËSIMIT

Njerëz të paautorizuar në kantiere ndërtimi

Mënyra më e mirë për t'i ruajtur nga lëndimi njerëzit që kalojnë pranë një kantieri ndërtimi është duke i mbajtur ata larg fizikisht. Vendosja e kufijve, me anë të përdorimit të rrethojave, është mënyra më e mirë për t'i ruajtur njerëzit e paautorizuar nga rreziku. Duhet të vendosen shenjat në këta kufij, duke paralajmëruar njerëzit që të mos hyjnë në zonën e ndërtimit. Këto masa mund të parandalojnë këmbësorët që të mos afrohen pranë aktiviteteve të punës, duke parandaluar gjithashtu njerëzit, të cilët mund të jenë kureshtarë për projektin, që të mos hyjnë në hapësirat e vendndërtimeve pas orarit të punës.

Hapja e gropave

Çfarëdo grope afër vendit të punës duhet të rrethohet ose të sigurohet ashtu që askush të mos shkelë aksidentalisht në vendin e gabuar. Të gjitha gërmimet dhe kanalet duhet gjithashtu të mbrohen siç duhet në mënyrë që askush të mos bie Brenda tyre dhe që toka afër tyre të mos jetë e paqëndrueshme.

Objektet që bien

Kur një objekt bie nga lartësia, ai mund të jetë shumë i rrezikshëm pavarësisht nga madhësia e tij. Meqenëse objektet që bien paraqesin rreziqe serioze, duhet të ekzistojnë masa të shumta mbrojtëse për të mbrojtur njerëzit që ecin pranë një vendndërtimi. Punëtorët mbajnë helmata sigurie - këmbësorët jo.

Metodat më të zakonshme për mbrojtjen e publikut nga rënia e objekteve përfshijnë strehët mbi trotuare, rrjetat dhe tubat. Strehët mbi trotuare janë struktura të qëndrueshme të ndërtuara rreth vendkalimeve. Rrjeta përdoret më lart për të kapur gjithçka që mund të bjerë. Tubat përdoren kur mbeturinat duhet të zhvendosen nga nivele më të larta në nivelin e tokës, të cilat lejojnë punëtorët të hedhin materiale pa u shqetësuar se dikush mund të goditet prej tyre.



Automjetet

Çdo kantier ndërtimi, i cili ndikon në zhvendosjen e rrugëve të rregullta të trafikut, ndikon njerëzit të hutohen ose të përfundojnë brenda kantierit të ndërtimit. Për të parandaluar aksidentet, duhet të vendosen shenjat që drejtojnë këmbësorët dhe automjetet e tjera. Pengesat, si shtyllat e lëvizshme ose të përhershme, mund të vendosen gjithashtu nëse njerëzit duhet të shmangin një zonë pune me trafik të lartë. Gjatë kohës kur trafiku është më i ngarkuar, mund të jetë gjithashtu një ide e mirë të përdorni një person me flamur (drejtues trafiku) për të drejtuar këmbësorët dhe automjetet e tjera.

Materialet e rrezikshme

Kantieret e ndërtimit shpesh janë plot me materiale të rrezikshme siç janë objekte të mprehta, materiale ndërtimi që kërkojnë përdorimin e PMP-ve (siç mund të jetë puna me çimento) dhe objektet e rënda. Vendosja e pengesave rreth kantierit duhet t'i mbajë njerëzit larg nga shumica e këtyre rreziqeve, por gjithsesi duhet të siguroheni që këto gjëra të mos ruhen në ose shumë afër vendit ku perimetri i kantierit është i hapur. Nëse në fund të ditës ndonjë material i rrezikshëm hidhet në mbeturina, sigurohuni që të jetë vendosur në kontejner mbeturinash dhe që ata kontejnerë të jenë të mbyllur.

Rreziqet e rrëshqitjes, pengimit dhe rënies

Për sa kohë që kantieri juaj ka sinjalistikë dhe pengesa të qarta dhe ju merrni masa paraprake për të parandaluar rrëshqitjen e objekteve që bien në rrugë etj., rreziqet e pengimit dhe të rënies për këmbësorët do duhej të ishin minimale. Sidoqoftë, ndryshimet në rrugët normale mund të bëjnë që njerëzit të pengohen dhe të bien, veçanërisht nëse sipërfaqet e ecjes janë jo të rrafshta. Në disa zona, kontraktorët do të duhet të ndërtojnë vendkalime të veçanta të përkohshme për këmbësorët. Prandaj kur vendkalimet e tilla të ndërtohen, punëtorët duhet të sigurohen që ato të jenë të rrafshëta.



Zhurma

Nivelet e zhurmës rreth vendeve të ndërtimit mund të jenë një shqetësim dhe madje një rrezik për ata që jetojnë ose punojnë afër. Përderisa një nivel i caktuar e zhurmës është e pashmangshme gjatë punës ndërtimore, sigurohuni që të ndiqni rregullat lokale për zhurmë për kohën kur mund të zhvillohen punimet dhe gjithashtu të merrni parasysh se sa e lartë mund të jetë zhurma që krijohet nga ato punime. Ndonjëherë mund të zgjidhni vegla elektrike dhe makineri të tjera që bëjnë më pak zhurmë, gjë që është më e sigurt edhe për punëtorët tuaj.

Pluhuri

Së fundmi, pluhuri është një rrezik i zakonshëm pranë vendeve të ndërtimit. Derisa punëtorët tuaj mund të vendosin aparate për frymëmarrje për t'i ruajtur ata, aparate të tilla nuk mund të vendosen në çdo këmbësor që kalon pranë kantierit të ndërtimit kur ai bëhet me pluhur. Zakonisht përdoret uji në vendet e ndërtimit për të minimizuar pluhurin, kështu që vendosni një sistem për spërkatjen me ujë të pjesëve të kantierit të ndërtimit, nëse pluhuri paraqet problem në atë vend.



ZHVILLIMI I PROCEDURAVE TË AUTORIZIMIT

Gjatë fazës së ndërtimit do të ketë shumë vizitorë në kantier, të planifikuar dhe të paplanifikuar. Kontraktorit “kryesor” i kërkohet të ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të siguruar që vetëm njerëzit e autorizuar të lejohen brenda kantierit të ndërtimit.

Për disa klientë, mund të ketë rregulla specifike ose nevoja që duhet të menaxhohen, të tilla si hyrja në një zonë brenda një vendi të rinovuar ose vizitat për t’ua treguar shtëpitë etj.

Kontraktori “kryesor”, personi ose organizata që kontrollon kantierin, duhet të ketë një sistem të vendosur për të menaxhuar rreziqet e shëndetit dhe sigurisë për vizitorët. Lloji i këtyre masave paraprake duhet të pasqyrojë madhësinë, rreziqet dhe kompleksitetin e kantierit dhe punimeve - ajo që është e përshtatshme për një projekt të madh mund të jetë mjaft e papërshtatshme për një projekt të vogël.

Përderisa pjesët e tjera të këtij Udhëzuesi përqendrohen në mbrojtjen e publikut, kjo pjesë ka të bëjë kryesisht me menaxhimin dhe kontrollimin e qasjes në vendndërtime për punëtorët dhe vizitorët. Ai ofron shembuj të procedurave të autorizimit dhe shpjegon se si ato mund të funksionojnë.

Kë duhet të autorizoni?

Përgjigja e thjeshtë është - çdo vizitor që ka nevojë të vijë në kantier. Kjo përfshinë edhe ata që kryejnë punë në kantierin e ndërtimit edhe vizitorët, të cilët normalisht duhet të përshtaten në një nga kategoritë e mëposhtme:

- Njerëzit të cilët kanë ndonjë përfshirje në procesin e ndërtimit, p.sh. përfaqësuesit e klientit, anëtarët e ekipit të projektimit, vozitësit me furnizime dhe kompanitë e shërbimeve;
- Personat që punojnë në kantier ose ata që janë pjesë e një procesi rregullator dhe kanë të drejtë ligjore për hyrje, siç janë zyrtarët e kontrollit të ndërtesës ose inspektorët e autoritetit lokal;
- Personat që punojnë në kantier, por nuk janë të angazhuar drejtpërdrejt në punë ndërtimore, siç janë stafi i shitjeve, personeli i sigurisë;
- Banorët e mundshëm të ardhshëm;
- Publiku i gjerë (përfshirë ata që mund të vijnë në kantier për të kërkuar punë).

Sigurohuni që vizitorët në kantier t'i raportojnë personit përgjegjës të kantierit dhe të dinë se ku të shkojnë - mund të duhet vendosja e njoftimeve në hyrje të kantierit. Mund të jetë e nevojshme një zonë pritjeje. Vizitorët nuk duhet të lejohen të enden pa shoqërues nëpër kantier. Një sistem për “caktimin e një vizite në vendndërtim” mund të jetë i nevojshëm në vendndërtime më të mëdha. Sigurohuni që vizitorët të shoqërohen në çdo kohë dhe të jenë të pajisur me çdo pajisje të nevojshme mbrojtëse, si helmata apo çizme. Organizoni dhe shënoni rrugët e qarkullimit në të tërë kantierin për t'i mbajtur vizitorët larg rreziqeve të kantierit.





AUDITIMET

Punëdhënësi duhet të ketë auditime të brendshme/vetë-inspektime sipas listës së sugjeruar të Shtojcës. Kjo do t'u mundësojë atyre që të menaxhojnë në mënyrë efektive shëndetin dhe sigurinë dhe gjithashtu t'i përgatisë ata për çdo auditim të jashtëm siç janë Rregullatori (Inspektorati i Punës etj.) dhe Certifikimi, nëse ka të tilla.

VËREJTJET PËRFUNDIMTARE

MBANI MEND: Nuk janë vetëm punëtorët që janë në rrezik nga puna në ndërtimtari. Pjesëtarët e publikut vriten dhe lëndohen rëndë çdo vit. Mënyra më e mirë për t'a ruajtur publikun është sigurimi i perimetrit të kantierit të ndërtimit dhe zbatimi i një procedure autorizimi për t'u siguruar që vetëm personat e autorizuar lejohen të hyjnë në vendndërtimet përkatëse.

Për më shumë informata, kontaktoni Inspektoratin e Punës.



SHTOJCA

Pyetjet e Auditimit të Punëdhënësit për "Mbrojtjen e Anëtarëve të Publikut" (Udhëzuesi), siç janë marrë nga dokumenti i listës së kontrollit të konsoliduar të Auditimit të SSHP-së të BE-së, i zhvilluar në mars të vitit 2021), janë dhënë si më poshtë:

Seksionet referuese:

3.2. Shenjat e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë

2.6.4. Rreziqet që lidhen me aksidentet në punë (Puna në lartësi)

2.6.5. Rreziqet që lidhen me aksidentet në punë (Puna në tokë)

1. A është vendosur numër i mjaftueshëm i shenjave paralajmëruese (për rreziqe të ndryshme që kanë nevojë për vëmendjen e publikut, nëse është e zbatueshme)?
2. A janë vendet ku ekziston rreziku i rënies së objekteve të shënuara me tabela dhe/ose ngjyrën e sigurisë? (për publikun, nëse është e zbatueshme)?
3. A shënohen rrugët e brendshme dhe të jashtme të trafikut (nëse është praktike) me vija të vazhdueshme në një ngjyrë sigurie të dukshme, duke marrë parasysh ngjyrën e tokës? A është e sigurt distanca midis automjeteve dhe objekteve/këmbësorëve? (për publikun, nëse është e zbatueshme)
4. A ka numër të mjaftueshëm të shenjave paralajmëruese të vendosura për të informuar publikun dhe a janë vendet e punimeve tokësore të rrethuara siç duhet?
5. A është siguruar që çdo vend pune nën zonën ku kryhet puna në lartësi të jetë i sigurt, përfshirë edhe objektet që bien? (për publikun, nëse është e zbatueshme)